

Tax Alert Albania

July - August 2023



pwc

PwC Albania - Tax Alert

Normative Act no. 2 dated 7.6.2023 'On some additions to law no. 29/2023, "On income tax"'

Except for the provisions of law no. 8438, dated 28.12.1998, "On income tax", amended, taxpayers, exporters of goods under the active processing regime, who in 2022 have exported no less than 70% of the total value of sales (including exports), do not have to prepay Income Tax installments for the months of June, September and December of 2023.

This normative act was approved on 21.7.2023, with the proclamation of Law No. 57/2023.

Source: Official Gazette no. 92, published on 23.06.2023 ([Link](#))
Official Gazette no.116, published on 03.08.2023 ([Link](#))

Law no. 38/2023 'For an amendment to the law no. 9975, dated 28.7.2008, "On national taxes"' amended

Subjects processing milk and its by-products, as well as subjects producing packaged food products, which contain powdered milk classified under codes 0402 10 19 and 0402 21 18 of the CN, milk whey classified under the heading 0404 10 of the CN and milk cream classified under the head 0402 of the CN, are exempt from paying the tax on powder milk, the tax on milk whey and tax for milk cream only for the imported amount, for the purpose of production, in accordance with the product label approved by the National Food Authority, where the percentage amount of these products, which are embodied in the final product, is recorded.

In case of the use of these raw materials not for their own purposes, and with a destination different from that for which the exemption is obtained, the subjects of processing and production of these products are obliged to pay the entire amount of the national tax for which they obtained the exemption.

Source: Official Gazette no. 95, published on 27.06.2023 ([Link](#))

Decision No. 431, dated 19.7.2023 "For an addition to the decision no. 1497, dated 19.11.2008, of the Council of Ministers, "On the printing of securities", amended"

According to this decision and in its meaning, fiscal stamps, road and railway transport tickets, as well as **coupons for biometric documents**, etc. will be considered as securities.

Source: Official Gazette no. 109, published on 25.07.2023 ([Link](#))

Akt Normativ nr. 2 datë 7.6.2023 'Për disa shtesa në ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat"'

Përfshirë parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve (përfshirë eksportet), nuk paguajnë këstet që parapaguhën në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023.

Ky akt normativ është miratuar në datën 21.7.2023, me shpalljen e Ligjit Nr. 57/2023.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 92, publikuar me 23.06.2023 ([Link](#))
Fletorja Zyrtare Nr. 116, publikuar me 03.08.2023 ([Link](#))

Ligj nr. 38/2023 'Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare"' të ndryshuar

Subjektet e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, si dhe subjektet e prodhimit të produkteve ushqimore të ambalazuara, të cilat kanë në përbërje të tyre qumësht pluhur të klasifikuar në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së, hirrë qumështi të klasifikuar në kreun 0404 10 të NKM-së dhe krem qumështi të klasifikuar në kreun 0402 të NKM-së, përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi vetëm për sasinë e importuar, për qëllim prodhimi, në përputhje me etiketën e produktit të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ku evidentohet sasia në përqindje të këtyre produkteve, që janë trupëzuar në produktin përfundimtar.

Në rast të përdorimit të këtyre lëndëve të para jo për qëllimet e veta dhe me destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin përfitohet përjashtimi, subjektet e përpunimit dhe prodhimit të këtyre produkteve detyrohen të paguajnë të gjithë vlerën e taksës për të cilën kanë përfituar përjashtimin.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 95, publikuar me 27.06.2023 ([Link](#))

Vendim Nr. 431, datë 19.7.2023 "Për një shtesë në vendimin nr.1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për shtypjen e letrave me vlerë", të ndryshuar"

Sipas këtij vendimi dhe në kuptim të tij, letra me vlerë do të vlerësohen pullat fiskale, biletat e transportit rrugor dhe hekurudhor, si dhe **kuponët për dokumente biometrike** etj.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 109, publikuar me 25.07.2023 ([Link](#))

PwC Albania - Tax Alert

Decision No. 457, dated 26.7.2023 "For some changes in decision no. 132, dated 7.3.2018, of the Council of Ministers, "On the methodology for determining the taxable value of the real estate "buildings", of the tax base for specific categories, the nature and priority of information and data for determining the base of tax, as well as the criteria and rules for the alternative assessment of the tax liability", amended"

The average reference prices of the sale and purchase of buildings used for residential purposes, by cities, for each municipality, by districts, and the average reference prices per square meter of construction area for non-residential premises, are determined according to the Annexes in this decision, as amended.

Source: Official Gazette no. 112, published on 28.07.2023 ([Link](#))

Notice No. 11871, dated 26.7.2023 "On the entry into force of a bilateral agreement with the Swiss Confederation"

International agreement between the Republic of Albania and the Swiss Confederation for Social Protection", signed on 18.2.2022, will enter into force on 1.11.2023.

Source: Official Gazette no. 113, published on 01.08.2023 ([Link](#))

Law No. 67/2023 "For an amendment and some additions to the law no. 9632, dated 30.10.2006, "On the local tax system", amended"

For entities that are in the process of applying for a building permit for the construction of structures intended for use in the agricultural and livestock sector, and for sports buildings according to the provisions in the legislation in force for sports, the infrastructure impact tax is no more than 1 (one) percent of the investment value, while for the Municipality of Tirana it is no more than 2 (two) percent of it.

Source: Official Gazette no. 116, published on 03.08.2023 ([Link](#))

The company "Albanian Electricity Exchange - Alpex" sh.a., makes the request to be designated as the Appointed Operator of the Electricity Market (NEMO)

Source: Official Gazette no. 116, published on 03.08.2023 ([Link](#))

Vendim Nr. 457, datë 26.7.2023 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar"

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve, dhe çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente jobanim, përcaktohen sipas Aneksëve në këtë vendim, të ndryshuara.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 112, publikuar me 28.07.2023 ([Link](#))

Njoftim Nr. 11871, datë 26.7.2023 "Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Konfederatën Zvicerane"

Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Mbrojtjen Shoqërore, nënshkruar më 18.2.2022, do të hyjë në fuqi më datë 1.11.2023.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 113, publikuar me 01.08.2023 ([Link](#))

Ligj Nr. 67/2023 "Për një ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar"

Për subjektet që janë në proces aplikimi për t'u pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksat e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 116, publikuar me 03.08.2023 ([Link](#))

Shoqëria "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – Alpex" sh.a., bën kërkesën të përcaktohet si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 116, publikuar me 03.08.2023 ([Link](#))

PwC Albania - Tax Alert

Law No. 65/2023 "For an addition and amendment to the law no. 10383, dated 24.2.2011, "On compulsory health insurance in the Republic of Albania", amended

Persons employed by profession in the field of information technology (IT) and registered in subjects with main activity in the field of technology information, who exercise their activity according to law no. 58/2022, "On the creation, organization and operation of technological and scientific parks", approved according to the legislation in force for this category, pay health insurance contributions at the level of the minimum monthly salary in the country, with the prior approval of the employee, recorded in the employment contract, regardless of the declared gross salary.

Source: Official Gazette no. 116, published on 03.08.2023 ([Link](#))

Law No. 64/2023 "On some additions and changes to law no. 7703, dated 11.5.1993, "On social insurance in the Republic of Albania", as amended"

The law expressly determines that the **maximum wage, for the effect of contributions, increases by the same amount and at the same time as the amount that the minimum wage increases on a national scale.**

Recipients of an old-age pension who are self-employed as sole workers in the private sector are exempted from the obligation to pay compulsory social security contributions. The payment of monthly pension installments is not prohibited for employed or self-employed beneficiaries, but the employment period is not recognized as an insurance period, under the effects of this law.

Source: Official Gazette no. 116, published on 03.08.2023 ([Link](#))

For some changes in decision no. 114, dated 1.3.2023, of the Council of Ministers, "On the use of the contingency fund for the financial compensation of the increase in social and health insurance contributions for every employee with a minimum wage, due to the increase of this wage at the national level"

Financial compensation for entities, for the period April-December 2023, is given for the number of employees for the month that requires compensation, but not more than the maximum number of employees with a gross salary range of 34,000 (thirty-four thousand) ALL up to 40,000 (forty thousand) ALL, declared for the December 2022 contribution period and no more than the number of employees, for the period requiring compensation.

Private entities must submit a request for application electronically through the "e-Albania" portal, for the period of compensation.

Source: Official Gazette no. 118, published on 07.08.2023 ([Link](#))

Ligj Nr. 65/2023 "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore", të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për këtë kategori, paguajnë kontributet e sigurimeve shëndetësore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, të evidentuar në kontratën e punës, pavarësisht pagës bruto të deklaruar.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 116, publikuar me 03.08.2023 ([Link](#))

Ligj Nr. 64/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"

Ligji përcakton shprehimisht se **pagë maksimale, për efekt kontributi, rritet me të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë me masën që rritet pagë minimale në shkallë vendi.**

Përfshihen nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore përfituesit e pensionit të pleqërisë, që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat. Pagesa e kësteve mujore të pensionit nuk ndalohet për përfituesit e punësuar apo të vetëpunësuar, por nuk u njihet periudha e punësimit si periudhë sigurimi për efekte përfitimi nga ky ligj.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 116, publikuar me 03.08.2023 ([Link](#))

Për disa ndryshime në vendimin nr. 114, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të kontigjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo të punësuar me pagë minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi"

Kompensimi financiar për subjektet, për periudhën prill-dhjetor 2023, jepet për numrin e të punësuarve për muajin që kërkon kompensim, por jo më shumë se numri maksimal i të punësuarve me fashën e pagës bruto 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë, të deklaruar për periudhën kontributive dhjetor 2022 dhe jo më shumë se numri i të punësuarve, për periudhën që kërkon kompensim.

Subjektet private duhet të dorëzojnë kërkesë për aplikim elektronikisht nëpërmjet portalit "e-Albania", për periudhën që kërkojnë kompensim.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 118, publikuar me 07.08.2023 ([Link](#))



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

